



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1651, datë 18.07.2011

Për

“Fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 18.07.2011, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;

5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008,

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e sipërmarrësit Neofone sh.p.k me nr. 80 prot, datë 09.05.2011 (AKEP: nr. 574/3 prot, datë 11.05.2011), “*Ankim Administrativ për moslidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit brenda afateve ligjore midis operatorëve Neofone sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a*”, drejtuar AKEP dhe për dijeni Eagle Mobile;
2. Shkresa e Eagle Mobile me nr. 1927 prot, datë 12.05.2011 (AKEP: 574/4 prot, dt. 12.05.2011), “*Mbi ankimin administrativ të Neofone sh.p.k*”, drejtuar AKEP dhe për dijeni Neofone;
3. Shkresa e Neofone nr. 83 prot, dt. 30.05.2011 (AKEP: 574/5 prot, dt. 30.05.2011), “*Për përshpejtimin e përfundimit të ankimit administrativ të Neofone sh.p.k*”, drejtuar AKEP dhe për dijeni Eagle Mobile;
4. Shkresa e Neofone nr. 89 prot, dt. 03.06.2011 (AKEP: 574/6 prot, dt. 06.06.2011), “*Përgjigja e shkresës tuaj nr. 1806 rot, dt. 05.05.2011 dhe nr. 1927 prot, dt. 12.05.2011*”, drejtuar Eagle Mobile per dijeni AKEP;
5. Shkresa e AKEP nr. 703/14 prot, datë 06.06.2011 “*Kërkesë për informacion mbi vijushmërinë e negociatave për lidhjen e MI*”, drejtuar Neofone dhe Eagle Mobile;
6. Shkresa e Neofone nr. 90 prot, dt. 14.06.2011 (AKEP: 934/3 prot, dt. 15.06.2011), “*Përgjigje shkresës tuaj nr. 2275 prot, datë 10.06.2011 mbi dokumentacionin për MI*”, drejtuar Eagle Mobile dhe për dijeni AKEP;
7. Shkresa e Neofone nr. 91 prot, dt. 23.06.2011 (AKEP: 934/9 prot, dt. 27.06.2011), “*Për moslidhjen e MI nag ana e Eagle Mobile dhe fillimin sa më shpejtë të procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me Eagle Mobile të ankimit administrativ nr. 80 prot, datë 09.05.2011*”, drejtuar AKEP;
8. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);

si dhe,

duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N:

Neofone sh.p.k, me ankimin administrative nr. 80 prot, datë 09.05.2011 (AKEP: nr. 574/3 prot, dt. 11.05.2011) “*Ankim për moslidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit brenda afateve ligjore midis operatorëve Neofone sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a*”, parashtron se:

1. Neofone i drejtohet për herë të parë Eagle Mobile me kërkesën për të lidhur marrëveshje interkoneksioni me anë të shkresës nr. 27 prot, dt. 19.04.2010 duke i paraqitur Eagle Mobile gjithë informacionin e nevojshëm për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit;

2. Neofone thekson se, pas kërkesës fillestare drejtuar Eagle Mobile ka kaluar një periudhë një vjeçare, gjatë së cilës Eagle Mobile në mënyrë të vazhdueshme ka shmangur dhe refuzuar lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit me Neofone, duke nxjerrë si shkak kryesor ankimit administrative që Eagle Mobile ka depozituar në AKEP;
 3. Neofone pas mbylljes nga AKEP të procedurës të shqyrtimit të ankimit administrativ të Eagle Mobile për Vendimin nr. 1467, datë 2.12.2010 “*Për miratimin e Ofertës Reference të Interkoneksionit të Eagle Mobile*”, ka dërguar sërish kërkesën për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit me anë të shkresës nr. 72 prot, datë 04.04.2011 drejtuar Eagle Mobile;
 4. Eagle Mobile me anë të shkresës me nr. 1454, datë 11.04.2011 i është drejtuar Neofone me argumentet se Eagle Mobile është në pritje të implementimit të portabilitetit të numrit, përditësimit të kuadrit rregullator dhe RIO-s, dhe se do të interkonektojë vetëm ata operatorë që përmbushin teknikisht kushtin e analizës dhe rrugëzimit në destinacionin e duhur të thirrjeve drejt numrave të portuar;
 5. Neofone thekson në ankimitin e tij se Eagle Mobile i ka kërkuar në mënyrë të pa drejtë Neofone një certifikatë të lëshuar nga AKEP e cila të vertetojë se operatori Neofone suporton portabilitetin e numrit, këtë pretendim Neofone e konsideron të pabazuar në kuadrin rregullator të AKEP;
 6. Neofone vlerëson gjithashtu se ka kaluar me sukses të gjitha testet e portabilitetit të numrit dhe operon me sukses këtë shërbim që prej datës 25.04.2011;
 7. Neofone me shkresën nr. 78, datë 22.04.2011 bën me dije Eagle Mobile se AKEP me Vendimin nr. 1560, datë 20.04.2011 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën reference të interkoneksionit të Eagle Mobile*”, ka përditësuar RIO-n e operatorit Eagle Mobile në lidhje me portabilitetin e numrave;
 8. Për sa më sipër, Neofone vlerëson se Eagle Mobile nuk duhet të shtyjë më detyrimet e tij rregullatore dhe ligjore për të lidhur marrëveshjen e interkoneksionit të kërkuar në mënyrë të vazhdueshme nga Neofone;
 9. Eagle Mobile me shkresën nr. 1806, datë 05.05.2011 i drejtohet Neofone dhe per dijeni AKEP, duke e njoftuar se ka ankimuar Vendimin nr. 1560, datë 20.04.2011 të KD të AKEP dhe se do të konsiderojë të gjitha kërkesat për lidhjen e marrëveshjeve të interkoneksionit me operatorët e tjerë vetëm pasi AKEP të marrë një Vendim përfundimtar mbi ankimin administrativ të Eagle Mobile;
 10. AKEP, pasi u njoh edhe me shkresën e mësipërme të Eagle Mobile, ka shqyrtuar ankimin administrativ të Eagle Mobile kundër VKD nr. 1560, datë 20.04.2011 dhe ka dalë me Vendimin nr. 1601, dt. 30.05.2011 “*Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Eagle Mobile ndaj Vendimit nr. 1560, dt 20.04.2011 të KD të AKEP*”, me anë të së cilit ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit nr. 1560, dt. 20.04.2011.
- Me anë të shkresës nr. 703/14 prot, datë 06.06.2011, AKEP i është drejtuar të dy sipërmarrësve Neofone dhe Eagle Mobile, duke iu kërkuar të paraqesin informacion në AKEP se si po vijnë negociatat midis tyre për lidhjen e MI, duke iu vendosur një afat maksimal për dërgimin e këtij informacioni deri më datë 13.06.2011;

11. Eagle Mobile me anë të shkresës nr. 2275 prot, datë 10.06.2011 “*Mbi dokumentacionin e nevojshëm për lidhjen e MI*”, i është drejtuar ABCom duke i kërkuar depozitimin e:
 - Dokumentacionit ligjor në zbatim të pikës 8.4 të ORI të Eagle Mobile;
 - Dokumentacionit të nevojshëm që konfirmon plotësimin e të gjitha kërkesave të ofrimit të shërbimit të portabilitetit të numrave për analizën dhe rrugëzimin e thirrjeve në destinacion;
 - Si dhe garancinë e përmbushjes së detyrimeve ligjore mbi lejimin e përgjimit në zbatim të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 dhe të Ligjit nr. 9157 date 04.12.2003;
12. Neofone sh.p.k me anë të shkresës nr. 90 prot, datë 14.06.2011 “*Përgjigje shkresës së nr. 2275, datë 10.06.2011*”, drejtuar Eagle Mobile dhe për dijeni AKEP thekson se Neofone:
 - a. Zotëron të gjithë dokumentacionin shkresor të nevojshëm në zbatim të pikës 8.4 të ORI së Eagle Mobile, duke bashkëlidhur dokumentacionin e nevojshëm për Eagle Mobile;
 - b. Neofone ka realizuar me sukses të gjithë procesin administrativ dhe teknik për portimin e numrit rigorozisht sipas kërkesave të AKEP për këtë projekt, duke realizuar me sukses ofrimin e shërbimit të portimit të numrave së bashku me analizën e dhe rrugëzimin e thirrjeve në destinacion dhe se ky është një proces që po vijon normalisht me sipërmarrësit AMC dhe Vodafone Al;
 - c. Neofone si operator i shërbimeve elektronike veprimtarive e tij, e ka të bazuar në respektimin e çdo detyrimi ligjor në zbatim të ligjit nr. 9918, dhe nr. 9157;
 - d. Për sa më sipër Neofone i drejtohet Eagle Mobile, të dërgojë brenda datës 17.06.2011 draft marrëveshjes së Interkoneksionit për lidhjen e MI;
13. Neofone në zbatim të nenit 60 të Ligj nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, në ankimin administrativ të tij ka kërkuar nga AKEP të dalë me një Urdhër për Eagle Mobile për ta detyruar që të lidhë marrëveshjen e interkoneksionit në kohën më të shkurtër të mundshme me Neofon, me qëllim uljen e kostove të shkaktuara në mënyrë të pa drejtë nëpërmjet rrugëzimit të trafikut nëpërmjet Albtelecom si dhe përmirësimin e parametrave të trafikut drejt Eagle Mobile.
14. Së fundmi Neofone, pas të gjithë korrespondence shkresore me Eagle dhe AKEP me anë të shkresës nr. 91 prot, datë 23.06.2011 (AKEP: nr. 934/9 prot, datë 27.06.2011), i është drejtuar AKEP për të filluar sa më shpejt procedimin administrativ të nisur nga Neofone me anë të shkresës me nr. 80 prot, datë 09.05.2011, pasi Neofone me gjithë përpjekjet e tij për të lidhur MI-në e kërkuar, nuk ka mundur ta realizojë atë me Eagle Mobile;
15. Për sa më sipër, ankimi administrativ i paraqitur nga sipërmarrësi Neofone sh.p.k me shkresën nr. 80 prot, datë 09.05.2011 (AKEP: nr. 574/3 prot, datë 11.05.2011) është në përputhje me:
 - Pikën 1, të nenit 50, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
 - Rregulloren nr. 18, datë 11.06.2010, “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” miratuar me VKD nr. 1296 datë 11.06.2010;

14. Duke qënë se, sipërmarrësit Neofone sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a megjithë negociatat, dhe përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit midis tyre, AKEP në zbatim të nenit 50 dhe në vijim të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me iniciativën e AKEP,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 te nenit 115, te Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 te nenit 21 te Rregullores së Brëndshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a.;
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me përbërje si:
 - Altin RRAPAJ Kryetar
 - Jetmir BRAHA Anëtar
 - Ded JAKAJ Anëtar
 - Florida ÇELA Anëtar
 - Xhenisa NELA Anëtar
3. Të njoftohen palët e interesuara Neofone sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**